



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

4852
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 13/11.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 83 Datë: 03.11.2025.

“Për lënien në fuqi të vendimit nr.62 datë 01.10.2025 për kalimin dhe përdorimin e ndërtesave publike ndërmjet Bashkisë Dibër dhe Institucioneve të Qarkut në zbatim të VKM nr.28 datë 27.01.2023.”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM

(Rishqyrtim)

Nr. 83 Datë 03/11/2025

“Për lënien në fuqi të vendimit nr.62 datë 01.10.2025 për kalimin dhe përdorimin e ndërtesave publike ndërmjet Bashkisë Dibër dhe Institucioneve të Qarkut në zbatim të VKM nr.28 datë 27.01.2023.”

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë “VKM nr.1533, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi apo në përdorim të Bashkisë Dibër, të Qarkut Dibër, bazuar në VKM nr.28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve” referuar shkresës nr.295/1 prot datë 09.09.2025 të dërguar nga Këshilli i Qarkut Dibër për arsye se zyrat ku aktualisht ushtrojnë veprimtarinë punonjësit e Bashkisë Dibër janë të pamjaftueshme për institucionin e Bashkisë, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbledhjen pasardhëse u rishqyrtua, kthimi i vendimit Nr.62 datë 01.10.2025 nga Prefekti i Qarkut Dibër, dhe pasi relatoi anëtarë i Këshillit Bashkiak Z.Hysen Uka, u hodh në votim pika për të cilën relatoi për të lënë në fuqi vendimin Nr.62 nga ku Këshilli Bashkiak Dibër e konsideroi vendimin e mëparshëm të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe në mbledhjen e datës **01.10.2025** me 19 vota pro 0 kundër 0 apstenim :

VENDOSI:

1. Kalimin e zyrave të Bashkisë në ndërtesën me nr.12/10-ND, 12/10, 12/10 ND2, 12/10 ND3, 12/10 ND4, 12/10 ND5 zkd. 2932 në të cilën janë vendosur përkatësisht institucionet si Prefekti i Qarkut Dibër, Këshilli i Qarkut Dibër, Zyra Arsimore, Dega e Thesarit dhe Zyra Statistikës.
2. Kalimin e zyrave të Institucioneve si Prefekti i Qarkut Dibër, Këshilli i Qarkut, Zyra Arsimore, Dega e Thesarit dhe Zyra e Statistikës në ndërtesën me nr.20/245 me sipërfaqe 209 m² truall + ndërtesë zkd 2932 ku aktualisht është godina e Bashkisë Dibër.

3. Miratimin e kalimit të pronësisë të pasurive të sipërpërmendura sipas formularit të përditësimit të pronës, në referim të VKM nr. 28 datë 27.01.2023 "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve".
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Pronave, Drejtoria e Planifikimit Kontrollit Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe me Institucionet e tjera.
5. Vendimi u shpall më datë **03.11.2025**.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

